



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	13 - 12 2021	viti god year	1
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	6062/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A Nr.903/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 903/2021 të datës 04.11.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi fshati Shishman, Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit/Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike „kontestimi konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 13.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.903/2021 e datës 04.11.2021, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 25.10.2021 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 04.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 25.10.2021 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, për shkak të cenimit themelor të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.11.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Komuna e Gjakovës.

Ndërsa me datë 18.11.2021, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 903/2021, e datës 04.11.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 14.10.2021; Vendimin e datës 19.10.2021 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës; letër referencën e datës 10.09.2021; kontratën e punës të datës 03.01.2019; referencën e muajit janar të vitit 2021 për Konkursin e datës 30.06.2021, i publikuar nga Komuna e Gjilanit; Aplikacionin e me shkresat e bashkangjitura: Diplomë e datës 30.11.2020, për Ankesën e datës 20.10.2021, drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; Kontratën e punës e datës 01.12.2010; letër reference ne datës 12.10.2021, për Vendimin e datës 25.10.2021 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; Përgjigjen në ankesë të datës 18.11.2021, me numër protokolli 5508/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar *sepse:*

Sipas shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Komuna e Gjakovës, me datë 27.08.2021 ka shpallur konkursin me numër reference RN00007548 për grupin Specialist i Gjeodezisë/Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 2. Organi i punësimit me rastin e shpalljes se konkursit, ka përcaktuar se konkurrimi është i hapur dhe të drejtë konkurrimi ka çdo kandidat i interesuar.

Ankuesi, për ketë pozitë të punës, me datë 13.10.2021 ka bërë aplikimin me numër aplikacioni RAN0001111. Ndërsa, me datë 19.10.2021 Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, në fazën e verifikimit të dokumentacionit, ka nxjerr Vendim për refuzimin e aplikacionit të ankuesit me numër RAN0001111, mbi bazën se ankuesit i mungon përvoja e punës pas diplomimit e që sipas konkursit në fjalë është se paku dy (2) vite.

I pakënaqur me vendimin mbi refuzimin e aplikacionit, ankuesi me datë 20.10.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 01-070/01-31657 në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës. Ky i fundit përmes vendimit të datës 25.10.2021, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit të datës 20.10.2021.

Kundër Vendimit të datës 25.10.2021, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të: cenimit themelor të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, duke pohuar se ai posedon përvojën e punës sipas Konkursit me nr. reference RN00007548 për pozitën e punës Specialist i Gjeodezisë/Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 2.

Sipas Konkursit me numër reference RN00007548 i shpallur me datë 27.08.2021, për grupin Specialistë i Gjeodezisë/Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 2, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Diplomë/a të studimeve universitare në Gjeodezi me të paktën 180, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to.*
- *Se paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit se i njëjti ka poseduar përvojën e punës për pozitën në fjalë, Kolegji nga analizimi i dosjes se aplikimit të ankuesit ka gjetur se ankuesi sipas Diplomës të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me numër 2227 të datës 30.10.2020, ka përfunduar studimet me datë 15.10.2020 duke marrë titullin Bachelor i Gjeodezisë, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka përmbushur kërkesat e Konkursit me numër reference RN00007548, përkatësisht nuk ka dy (2)vjet përvojë punë pas diplomimit, kështu që pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.

Andaj, duke marr parasysh konstatimin si me lartë, Kolegji vlerëson se Divizioni i Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 19.10.2021 me të cilit ka refuzuar aplikacionin e ankuesit për shkak të mos përvojës pas diplomimit dhe Vendimit të datës 25.10.2021 për refuzimin e ankesës të datës 20.10.2021, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 paragrafi 1, 2, dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: 1. *Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim* 2. *Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak.* 5. *Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin..* ndërlidhur me nenin 34 paragrafi 6 nen paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi është i paligjshëm, mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente,/Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën ka pranuar vendimin. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
lënda me numër A.nr.903/2021

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

